

Universiteti Bujqësor i Tiranës
Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit
Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve
(Department Reference)

Prodhimi i integruar – alternativë efektive për minimizimin e përdorimit të pesticideve



Prof. Dr. Shpend SHAHINI

Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve, si **Departament Reference**, bazuar në ligjin Nr. 9908, datë 24.04.2008 “Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve”, implementon detyrat:

- Monitorimin e parazitëve karantinorë, parcaktimin e statusit të tyre, metodat e kontrollit karantinor.
- Diagnostikimin dhe prognozë – sinjalizimin e parazitëve duke përcaktuar dhe masat e luftimit të tyre.
- Provat biologjike – agronomike të PMB-ve.\
- Harton projekt etiketat e PMB-ve që vijnë për regjistrim.

- Kontrollin fitosanitar për çertifikimin e materialit shumëzues dhe mbjellës.
- Trajnimin dhe kualifikimin e specialistëve të strukturave të shërbimit të mbrojtjes bimëve në rang kombëtar.
- Përpunon dhe ndjek strategjitë e Menaxhimit të Integruar si dhe Metodat Biologjike të kontrollit të parazitëve të bimëve me qëllim ruajtjen e Biodiversitetit.
- Harton metodika laboratorike dhe manuale praktike për laboratorët e Mbrojtjes së Bimëve të AKU-së si dhe atyre të pikave doganore.

Implementimi i komponentit parandalim

Hallka më e rëndësishme në:

- garantimin e pastërtisë fito-sanitare
- parandalimin e problematikave të mbetjeve të pesticideve
- realizimin e prodhimit të integruar bujqësor vendas
- krijimi i mundësive për një bujqësi të qëndrueshme

Kjo arrihet nëpërmjet:

- Diagnostikimit të problematikave fito-sanitare në kulturat intensive (perime, drufrutorë dhe vresht), si potenciale eksportuese nga fermeri ynë, bazuar në një punë konkrete monitoruese në të gjithë territorin e vendit.
- Përcaktimit të kufijve të ndërhyrjeve për kontrollin e parazitëve në kuadrin e menaxhimit të integruar për kulturat bujqësore.
- Përcaktimit të përdorimit të lëndëve aktive në përputhshmëri të plotë me problematikat fitosanitare.
- Përcaktimit të frekuencës së përdorimit të lëndëve aktive bazuar në koncepte shkencore agronomike.

Prodhimi i integruar – prodhim me cilësi të lartë


Me përparësi:

- ❖ teknikave të kultivimit të sigurtë nga ana ekologjike
- ❖ minimizimit të përdorimit të kimikateve sintetike
- ❖ përdorimit të teknikave biologjike, gjenetike, bujqësore
- ❖ ruajtjes së agroekosistemeve natyrale

Rritje e sigurisë së SHËNDETIT TË NJERIUT DHE MJEDISIT

Në kuadrin e realizimit të prodhimit të integruar, është hartuar protokolli sipas standarteve dhe kritereve shkencore në përputhshmëri me vendet e BE-së, duke garantuar:

- prodhim cilësorë
- garanci për shëndetin
- ruajtje të agroekosistemit natyral



Nëse nga laboratorët e autorizuar nuk përcaktohet problematika fito-sanitare për arsye teknike:

Departamenti i Referencës realizon analizimin e materialit bimor të ardhur nga importi për parazitët objekte karantinore që nuk lejohen të futen në territorin e Republikës së Shqipërisë (sipas **VKM nr. 750, dt. 14.07.2010, Aneksi I, Pjesa A “Parazitë hyrja dhe përhapja e të cilëve brenda territorit të Shqipërisë është e ndaluar”**), si dhe sipas kërkesave të **EPPO** (Organizata Europiane e Mbr. së Bimëve) dhe **IPPC** (Konventa Ndërkombëtare e Mbr. së Bimëve).



Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve është pjesë aktive e hartimit të rregulloreve për parazitët objekte karantinore.

- Mbi miratimin e "Rregullave të inspektimit karantinor fitosanitar". VKM nr. 750, dt 14.07.2010. Shpallur në Fletoren Zyrtare Nr. 139 dt. **18 Tetor 2010.**

- Miratimin e "Rregulla mbi sigurinë fitosanitare të materialit ambalazhi prej druri që qarkullon në tregëtinë ndërkombëtare dhe në territorin e Republikës së Shqipërisë".

Kjo rregullore është konform legjislacionit dhe procedurave të inspektimit fitosanitar në pikat e inspektimit kufitar të Bashkimit European.

- Rregullore për monitorimin, kontrollin dhe marrjen e masave karantinore për *Diabrotica virgifera virgifera*, Le Conte.



Foto nga:
E.Çota,
Gjegjan, Pukë

- Miratimin e “Rregullore mbi masat për luftën e detyrueshme kundra zjarrit bakterial, *Erwinia amylovora*, në territorin e Republikës së Shqipërisë”.



Foto: H. Pace

Puna monitoruese në kuadrin e emergjencave fitosanitare karantinore.

- Hartohen teknikat monitoruese dhe masat e kontrollit për tenjën e domates *Tuta absoluta*.



Foto: Sh. Shahini



- Hartohen teknikat monitoruese dhe masat e kontrollit për hundëgjatin e kuq të palmës *Rhyncophorus ferrugineus*.



- *Bemissia tabacci*, determinohet dhe njoftohet menjëherë Ministria e Bujqësisë.
- Tripsi i luleve, *Frankliniella occidentalis*, Pergante. Determinohet dhe njoftohet Ministria e Bujqësisë.
- Miza minuese, *Liriomyza huidobrensis*, Blanch. Determinohet dhe njoftohet Ministria e Bujqësisë.
- Breshkëza e Kalifornisë, *Quadraspidiotus perniciosus*.

- Prognozë – sinjalizimi

1. Diagnostikimin dhe studimin e bioekologjive të parazitëve të bimëve.
2. Përcakton masat e kontrollit të tyre në kuadrin e kontrollit të integruar.
3. Përzgjedhjen e metodave dhe teknikave të cilat kanë si bazë implementimin e protokolleve standarte të BE.

Zonat e mbrotjura

- Në kulturën e patates në zonën e Divjakës, është kryer një punë intensive duke monitoruar një sipërfaqje prej rreth 350 ha dhe duke realizuar analiza laboratorike për të gjithë parazitët objekte karantinore.



Konkludohet se nuk rezultojnë të pranishme parazitë objekte karantinore si:

- kalbëzimi unazor *C. michiganensis* spp. *Sepedonicus* (Ring rot)
- kalbëzimi ngjyrë kafe *R. solanacearum* (Brown rot)
- *Globodera pallida*
- *Globodera rostochiensis*
- *Ditylenchus destructor*

si kushte kryesore për eksportin e patateve.

Në kuadrin e dëmtuesve me rëndësi ekonomike të veçantë

- Është hartuar metodika e punës dhe masat e kontrollit për mizën e ullirit, *Bactrocera oleae*, nëpërmjet eko-grackave.



Është hartuar metodika e punës dhe masat e kontrollit për mizën mesdhtare të frutave, *Ceratitis capitata*, në agrume, nëpërmjet teknikës së kapjes masive, e përdorur për herë të parë në vendin tonë.



Faleminderit